



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË
Dhoma Penale

Nr.2773S.P/3994/500 Regj.Themeltar

Nr.497

Vendimi

Dt.Regj.S.P./02.11.2021/13.12.2021 Regj.Them.

Dt. 28.02.2021

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
Gjyqtar Altin Abdiu

asistuar nga sekretare gjyqësore Besarda Allaraj, date 28.02.2022, perfundoi se shqyrtuari ne seance gjyqësore çeshtjen penale, që u përket :

Prokuroria Prane Gjykates Se Rrethit Gjyqësor Tirane, me prokuror **Enklid Gjini**.

I pandehur: **Aleksandre Sulaj**, i biri i Panajot dhe Aneta, dtl. 11.11.2000, lindur dhe banues ne Tirane, rruga “Federik Shiroka”, shk. 3, ap. 15, shtetesi dhe kombesi shqiptare, me arsim 8 vjeçar, beqar, me mase sigurimi “arrest ne shtepi”, i padenuar, identifikuar me pashaporte me nr. personal K 01117062 U, mbrojtur me deklarim nga av. Alfred Gjoni, Dhoma e Avokatise Tirane.

Akuzuar:Per kryerjen e vepres penale “Prodhim dhe shitje narkotikesh”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Objekti:Dergimin e çeshtjes ne gjyq.

Baza Ligjore:Neni 331 Kodi Procedures Penale.

Ne fazen e diskutimeve prokurori kerkoi pranimin e kerkeses per dergimin e çeshtjes ne gjyq dhe ne konkluzionet perfundimtare kerkoi:

- Deklarimin fajtor te te pandehurit Aleksander Sulaj, per kryerjen e vepres penale “Prodhimi dhe shitje narkotikesh” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, denimin e tij me 5(pese) vite burgim.
- Aplikimin e kerkesave te nenit 406 te K.Pr.Penale.
- Lenda narkotike sekuestruar dhe evidentuar ne “Procesverbalin per sekuestrimin e sendeve” te dates 07.05.2020, te asgjesohet.
- Nje telefon e markes Iphone 7 + ngjyre e zeze, ti kthehet te pandehurit.
- Shpenzimet proceduriale ti ngarkohen te pandehurit.

-Avokati dhe i pandehuri ishin dakort me kerkesen e prokurorit per kalimin e ceshtjes per gjyq, i pandehuri paraqitet kerkesen për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar dhe ne konkluzionet perfundimtare avokati dhe i pandehuri kerkuan nje denim sa me te bute me burgim dhe pezullimin e ekzekutimit te ketij denimi ne baze te nenit 59 Kodi Penal.

-I pandehuri Aleksandre Sulaj i kerkoj gjykates meshire dhe ishte dakord me avokatin. Gjykata pasi shqyrtoi ceshtjen në tërësi,

V Ë R E N

Prokuroria Pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane, ka paraqitur kerkesen per dergimin ne gjyq te ceshtjes penale ndaj te pandehurit Aleksandre Sulaj, i akuzuar per kryerjen e vepres penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikeve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Nga shqyrtimi gjyqësor i ceshtjes, e cila eshte ne juridiksionin dhe kompetencen e kesaj Gjykate, ka rezultuar se:

Në datë 14.04.2021 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi bazën e akteve të ardhura nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë është regjistruar procedimi penal nr. 2600 për veprën penale Prodhimi dhe shitja e narkotikeve parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Seksioni për Hetimin e Narkotikëve, Drejtoria Vendore te Policisë Tiranë, dispononte informacione të siguruar në rruge operative, se shtetasi Aleksandre Sulaj shiste lende narkotike të llojit cannabis sativa ne rrugën "Mujo Ulqinaku". Në datën 07.04.2021 janë planizuar shërbimet për verifikimin e këtij informacioni. ne rr. "Mujo Ulqinaku". Rreth orës 13:30 shërbimet konstatuan shtetasin Aleksandre Panajot Sulaj në nje ndërtesë dy katëshetë pabanuar pa dyer e pa dritare, e cila ndodhet ne zonën afer shkollës Faik Konica. Shtetasi Aleksandre Sulaj po qëndronte perballe hyrjes kryesore nga ana veriore e kësaj godine, cili per nje moment ka shkuar ne krah te djathte te deres kryesore te kesaj godine te pa banuar ne nje dritare ne forme rrethore dhe pasi ka mare diçka aty eshte larguar 2-3 metra nga dritarja dhe ne doredukej dicka si qese farmaceutike me bime te dyshuar narkotike te llojit Cannabis Sativa. Ne kete shtetate shërbimet e policisë nderhynë duke u prezantuar si "Policia Anti Droga" dhe shtetasi Aleksandre Sulaj, sapo konsatoi prezencen prezencën e tyre u largua me vrap duke u humbur nga sytë shërbimeve. Në momentin që u largua vrap shtetasit Aleksandre Sulaj i ra nga xhepi telefoni i markes Iphone 7 Plus", ngjyrë e zezë, me prekje, me IMEI1: 356693080001029, me nr. të kompanisë celulare "Vodafone" +355 69 263 3921, i kycur me paswordin 2000.

Ne keto rrethana shërbimet kontrolluan vendin ku qëndronte shtetasi Aleksandre Sulaj, dhe ne dritaren ne fjale, gjeten nje qese plastike, brenda se ciles ishin kater qesese si ato farmacive me lende te dyshuar narkotike te llojit cannabis sativa. Nderkohe ne afersi eshte gjetur edhe nje qese plasmasi me mbishkrimin "CITLIYO", ku u konsatuan edhe kater qese te tjera si ato te farmacive me lende te dyshuar narkotike te llojit cannabis sativa.

Ne vijim u krye kqyrja e vendit të ngjarjes me ekspert kriminalist dhe u administruan dhe sekuestruan provat materiale me qellim egzaminimin laboratorik të tyre. U bë peshimi i tetë qeseve farmaceutike me lënde te dyshuar narkotike të llojit cannabis sativa dhe rezultuan me peshë totale 10 (dhjetë) gram. Pas peshimit provat u futën në qesen e provave me Nr.UNIK. A00002556. Eshte pyetur ne cilesine e personit që ka dijeni për veprën penale i ati i shtetasi Aleksandre Sulaj, shtetasi Panajot Sulaj,i cili deklaroi se: Numri i telefonit 0692633921 eshte ne perdorim te djalit te tij Aleksandre Sulaj. Ne dijenine e tij ai perdor një telefon IPHONE 7 Plus, ngjyre e zeze. Deklaron se djali i tij Aleksandre, eshte i papune dhe ditën ne fjale eshte larguar nga shtepia rreth ores 10:00, dhe nuk ka dijeni ku ka shkuar. Deklaron se Aleksandre në shtëpi rri shumë pak dhe kur vjen aty i bie shume telefoni. Ngrihet dhe del orar pa orar. I pyetur se ne dijenine e tij me ke shoqerohet shtetasi Aleksandre Sulaj, ai u shpreh se nuk e di specifikisht por

di qe shoqerohet me disa cuna tek zona e Ish Parkut tek 21 -dhjetori dhe me pas ka qendruar ne "Myslym Shyri". Në vijim i është marë deklarim punonjësve të policisë Mariglen Beqo, Vladimir Gega dhe Abedin Metko, te cilet deklaruan:

Ne date 07.04.2021 nga ana e Seksionit per Hetimin e Narkotikeve ka patur nje sere Informacione ku nder te tjera thuhej se shtetasi Aleksandre Panajot Sulaj merrej me meret me Prodhim dhe shitje lendesh narkotike te llojit "Canabis Sativa ne rrugen "Mujo Ulqinaku" ne afersi te shkolles Faik Konica qyteti Tiranes ,i cili pasi e merte bimen narkotike ne sasi te mbedha prej 1-2 kg e ndante ne banesen e tij ne doza dhe me pas e shiste ate ne perdorues te ndryshem ne kete adrese. Ne baze te ketyre te dhenave ne date 07.04.2021 ne oren 13:30 jemi vendosur me sherbim ne kete adrese dhe kemi kostatuar shtetasin Aleksandre Sulaj i cili po rrinte nga ana verjore e hyrjes se kesaj ndertese dhe per nje moment eshte afruar te dritarja ne forme rrethore ne krah te djathte te hyrjes kryesore dhe pasi ka mare dicka aty qe ne pamje te pare na u duk si qese farmaceutike me bime te dyshuar cannabis Sativa eshte larguar disa metra dhe ne kete kohe ne kemi nderhyre per kapje te tij. Ne momentin qe nderhyme ne duke u prezantuar si "Anti droga" ai me nje here ka ikur me vrap dhe duke ikur me vrap nga xhepi i ka rene nje telefon celular qe e kemi pershkruar te raporti i sherbimit. Nga ana jone i jemi vene ne ndjekje po nuk arrihem ta kapnim dot me vrap Me pas beme sigurimin e vendit te ngjarjes dhe kemi kostatuar se te dritarja ku shkoj shtetasi Aleksandre Sulaj pak minuta para se te nderhynim ne ish-in nje qese plastike me shirit kapese ku brenda kishte kater qese si ato te farmacive brenda se cilave ka material bimor te dyshuar si lende narkotike e llojit cannabis sativa si dhe prane kesaj gjendej dhe nje qese tjeter si ato te amballazhit te fara luledielli me mbishkrim "CITLIYO" ku edhe brenda kesaj qeseje ndodheshin kater qese te tjera si ato te farmacive ku kishin material bimor te dyshuar si lende narkotike te llojit "Cannabis sativa". Ne kete suate kam siguruar vendin e ngjarjes deri ne mbritjen e grupit hetimor Gjithashtu kam dhene urdher per shkuarjen e kontroll banese te shpija e tij. Ne momentin qe e kemi kostatuar shtetasin Aleksandre Sulaj ka gene i vetem dhe ishte para hyrjes kryesore te kesaj baneses se braktisur nga ana verjore saj dhe po rrinte aty para. Per nje moment ka shkuar te kjo dritarja dhe dicka ka mare aty qe ne na u duk si qese farmaceutike me bime te dyshuar narkotike te llojit cannabis Sativa dhe ne kete moment kemi nderhyre per ta kapur po ai me te bere prezantimin ne si " Policia Anti Droga " ka ikur me vrap dhe duke ikur i ra dhe telefoni celular qe e kishte ne xhep. Ky shtetas pasi mori qesen qe na u duk ne si qese farmaceutike me bime te dyshuar narkotike te llojit cannabis Sativa ka qene rreth 2-3 metra larg nga vendi ku u gjeten keto qese te tjera dhe ne momentin qe ne nderhyme ai iku me vrap.

Me sa kam fiksuar nuk kam pare njeri aty prane se dhe ka qene moment ku une e kisha perqendrimin per kapjen e tij dhe jo per kontrollin e ambjentit perreth se kush ishte i pranishem Me sa kam fiksuar ky shtetas Aleksandre Sulaj ka gene i vetem. U krye kqyrja aparatit celular të shtetasit Aleksandre Sulaj te gjetur ne vendngjarje, dhe janë fiksuar të dhenat që e lidhin aparatit celular me kete shtetas, si marka, modeli dhe ngjyra me ate te deklaruar nga shtetasi Panajot Sulaj. Ne aparat celular rezultoi numri +355 69 263 3921 i cili përkon me numrin qe shtetasi Panajot Sulaj deklaroi se ishte në përdorim të djalit të tij Aleksandre Sulaj. Nderkohe prej kqyrjes u fiksua edhe emertimi i aparatit celular "Aleksandro Sulaj" aleksandrosulaj2000@gmail.com. dhe adresa e emailit rregjistruar.

Kqyrja vijoi në rubrikën e fotove dhe videove te aparatit celuar ku konstatohen fotografi te bera nga ky aparat celualr me permbajtje imazhesh te boceve dhe qeseve me boce te lendes narkotike cannabis sativa. Ndërkohë në rubrikën e lokacioneve te aparatit celular, u konsatua se ne shumicen e fotove dhe videove te bera nga ky aparat celular, ishte e rregjistruar dhe vendodhja

gjeokrafike e vendit ku eshte bere foto ose video. Per interes te hetimeve u kqyren foton e bera ne zonen e rruges "Mujo Ulqinaku", dhe u konstatuan disa video dhe foto ku shfaqen pamje te boceve te bimes narkotike cannabis sativa.

Në aparatin celular kishte shume foto me permbajtje imazhesh të boceve te bimes narkotike cannabis sativa, dhe te dhena te tjera me interes, te cilat nuk ishte e mundur te fiksoheshin në këtë faze te hetimeve. U kryen vendimet e ekspertimit kimik, biologjik dhe vleresues daktiloskopik lidhur me rastin si dhe është administruar raporti i sherbimit dhe procesverbali i kqyrjes se vendit te ngjarjes.

Shtetasi Aleksandre Sulaj u shpall në kerkim policor në lidhje me ngjarjen e datës 07.04.2021, si si i dyshuar per vepren penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. U krye kontroll ne banesen e shtetasit Aleksandre Sulaj, por nuk u gjet aty. Gjate kontrollit nuk u konstatua asnje send i kundrligjshem apo me interes per hetimet. Ne keto rrethan u perpilua proceverbali i kontrollit te vendeve dhe procesverbali i kërkimit të personit që nuk gjendet.

Sipas aktit të ekspertimit kimik nr. 5922 datë 18.06.2021 për lëndën narkotike të sekuestruar shtetasit Aleksandre Sulaj ka rezultuar se;

Materiali bimor objekt ekspertimi janë cannabis produkt herbal i bimës cannabis sativa.

Pesha pa ambalazh e mayterialit bimor objekt ekspertimi është 9 gramë. Ne lidhje ne analizimin e provat e administruara ne ngarkim te shtetasit. Aleksandre Sulaj ka rezultuar se nga ana e tij, jane konsumuar element e vepres penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" te parashikuar nga neni 283/1 K.Penal, pasi, ai ka poseduar një sasi prej prej 9 gram grame. Eshtë për tu vënë në dukje se lënda narkotike e mbajtur nga shtetasi Aleksandre Sulaj është e ndarë në doza dhe jo si një e vetme e në këto kushte nuk është dozë e vetme për përdorim vetjak.

Ne pefundim te hetimeve prokurori ka konkluduar se nga i pandehuri Aleksander Sulaj me veprime te kundraligjshme te kryera ka konsumuar elementët e vepres penale "Prodhim dhe shitje narkotikesh" parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal

Akuza ne ngarkim te tij provohet nga: Procesverbal i kqyrjes së vendit të ngjarjes; Procesverbal i kontrollit të vendeve; Procesverbal sekuestrimi; Raport sherbimi i mbajtur ne date 08.04.2021 nga punonjesit e policise Mariglen Beqo, Andi Kano etj; Akt ekspertimi kimik i lendes; Akt ekspertii daktiloskopik; Deklarimet e shtetasve.

Në gjykim avokati dhe i pandehuri ishin dakort me burimet e provave të paraqitura nga prokurori dhe i kërkuan Gjykatës të procedohet me gjykim të shkurtuar.

Avokati mbrojtese kerkoi pushimin e çeshtjes penal pasi fakti penal nuk provohet pasi i mbrojturi prej meje ka qene rastesisht.

-I pandehuri ishte dakort me avokatin e tij. Kam qene rastesisht nderkohe qe erdhi policia ika me vrap, te zona ku ka ndodh ngjarja, thjesht po kaloja rastesisht, kur ika me vrap telefoni me ra, pastaj filluan kontrollet dhe gjeten lend narkotike. Lenda narkotike nuk ishte e imja. Ne rast se gjykata e gjen fajtor kerkojme te aplikojme nenin 59 te Kodit Penal.

-Prokurori replikon se se pari nuk eshte kapur rastesisht sepse kishte informacion dhe ishte i vezhguar nga policia, vendi ku eshte gjetur lenda narkotike eshte godine e braktisur, sapo ka pare policine eshte gjetur nga telefoni i sekuestraur ku rezulton se dhe vepra penale eshte e provuar. Nuk eshte asnje nga rrethanat dhe kushtet e nenit 59 te Kodit Penal, sepse as nuk ka pranuar akuzen dhe nuk ka kerkuar falje.

Vlersimi i gjykates.

Gjykata, e bazuar ne nenet 331, 332/dh pg. 1 germa "c", 405 të K.Pr.Penale, per kete çeshtje çmon se, nuk jemi perpara rasteve te pavlefshmerise se kerkeses se prokurorise per dergimin e

çeshtjes ne gjyq, te percaktuara ne nenin 331/2 te K.Pr.Penale. Nuk u konstatuan; akte te pavlefshme, prova te paperdorshme, nevoja per marrjen e provave te tjera. Veprimet hetimore te prokurorit jane kryer konform procedurave ligjore.

Meqenese çeshtja zgjidhjet ne gjendjen qe jane aktet dhe per shkak se nuk egziston rasti ndalues i percaktuar ne nenin 403/2 te K.Pr.Penale dhe ndonje nga rastet e percaktuara ne paragrafin 7 te ketij neni per mospranimin e gjykimit te shkurtuar, Gjykata ka vendosur pranimin e kerkeses te pandehurit per zhvillimin e gjykimit të shkurtuar.

Në paragrafin e pare te nenit 283 të Kodit Penal me titull “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, është parashikuar se :

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë”.

Në këto kushte, bazuar në aktet e fashikullit hetimor të shendërruara në dosje gjyqësore, për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, Gjykata e gjen të drejtë akuzën e ngritur nga prokuroria, sepse, krijon bindjen tej çdo dyshimi te arsyeshem se i pandehuri Aleksandre Sulaj me veprimet e kundraligjshme të kryera, ka konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 pg. 1 i Kodit Penal.

- Objekt i kësaj vepre penale, janë marrdhëniet juridike të vendosura me ligj dhe akte nënligjore, për të siguruar kontrollin mbi mbajtjen, prodhimin, shitjen, përdorimin e lëndëve narkotike, të mbrojtura posaçërisht nga legjislatiioni penal ndaj veprimeve dhe mosveprimeve kriminale, cënimi i të cilave passjell përgjegjësi penale.
- Nga ana objektive, vepra penale është kryer nëpërmjet veprimeve të kundraligjshme të të pandehurit, siç janë mbajtja e tete qeseve farmaceutike me lende narkotike cannabis sativa me peshe te pergjithshme 10 gram.
- I pandehuri është subjekt i kësaj vepre penale, sepse ai ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm përpara ligjit për veprën e kryer.
- Nga ana subjektive vepra penale është kryer me dashje direkte pasi i pandehuri ka qënë në dijeni të faktit se mbajtja e lendes narkotike e sekuestruar ndalohe me ligj.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, Gjykata ka parasysh:

Rrezikshmërinë të lartë shoqërore të veprës penale, e cila është kryer në formën e mbajtjes së lëndës narkotike dhe është e përhapur në shoqëri.

Rrezikshmërinë jo te larte shoqërore të të pandehurit për të cilin rezulton se:

- i eshte caktuar masa e sigurimit “arrest ne shtepi”,
- është i padënuar,
- mban qendrim mohues per veprimet e kundraligjshme te kryera.

Nisur nga, rrezikshmeria shoqerore e vepres penale dhe e te pandehurit, shkalla e fajit, Gjykata çmon se duhet pranuar kerkesa e prokurorit per denimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.

Ne zbatim te nenit 406.1 te K.Pr.Penale,te pandehures i ulet 1/3 e denimit per shkak te zhvillimit te gjykimit te shkurtuar dhe denohet perfundimisht me 3 (tre) vite 4 (kater) muaj burgim.

Per sa i përket kërkeses se mbrojtjes per pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim per te pandehurin.

Gjykata i referohet nenit 59 te K.Penal, me titull “Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë” në të cilin ndër të tjera është parashikuar se :

- *“Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personitkushteve shëndetësore, ... dhe nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin... si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, Gjykata kur jep nje denim me burgim deri ne pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit...”*

Duke analizuar dispoziten e mesiperme, ne kushtet kur nuk u provua ne kete gjykim tej çdo dyshimi te arsyeshem fakti i shitjes se lendes narkotike nga i pandehuri Gjykata çmon se i pandehuri Aleksandre Sulaj i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, sepse :

- ka një rrezikshmëri të paket shoqërore,
- i është caktuar një masë dënimi me burgim nën pesë vjet.

Nga sa u arsyetua me sipër, Gjykata çmon se duhet pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurin Aleksandre Sulaj.

I dënuari Aleksandre Sulaj duhet të mbajë kontakte me Zyren Vendore e Shërbimit te Provës Tirane dhe të vihet në provë për një afat 4 (kater) vjeçar me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Ne zbatim te nenit 60/9 te Kodit Penal, duhet te detyrohet i pandehuri Aleksandre Sulaj qe te mos shoqerohet me persona te denuar ose me precedente penale.

Meqenese i pandehuri rezultoi fajtor per vepren penale per te cilen akuzohet, ne baze te neneve 485 dhe 393 te K.Pr.Penale, ai duhet te ngarkohet me pagimin e shpenzimeve proceduriale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në zbatim dhe të neneve 379 - 384, 390 të K.Pr.Penale,

VENDOSI

- Deklarimin fajtor te pandehurit Aleksandre Panajot Sulaj per kryerjen e vepres penale “Prodhim dhe shitje narkotikesh” parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, denimin e tij me 5 (pese) vite burgim.
- Ne zbatim te nenit 406/1 te K.Pr.Penale, te pandehurit Aleksandre Panajot Sulaj i ulet 1/3 e denimit dhe denohet me 3 (tre) vite e 4(kater) muaj burgim.
- Bazuar ne nenin 59 te K.Penal, te pezullohet ekzekutimi i pjeses se mbetur pa vuajtur te denimit me burgim per te pandehurin Aleksandre Panajot Sulaj.
- Urdherohet i denuari Aleksandre Panajot Sulaj, te mbaje kontakte me Zyren Vendore te Sherbimit te Proves Tirane dhe te vihet ne prove per nje afat 4 (kater) vjeçar, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjetet penale. Afati i proves fillon nga e nesermja e shpalljes se ketij vendimi.

- Ne zbatim te nenit 60/9 te Kodit Penal, detyrimin e te denuarit Aleksandre Panajot Sulaj qe te mos shoqerohet me persona te denuar ose me precedente penale.
- Provat materiale:

-Lenda narkotike e sekuestruar dhe evidentuar ne "Procesverbalin per sekuestrimin e sendeve" te dates 07.05.2020, te asgjesohet.
-Nje telefon e markes Iphone 7 + ngjyre e zeze, ti kthehet te pandehurit.

- Heqjen e mases se sigurimit "arrest ne shtepi" ndaj te pandehurit Aleksandre Panajot Sulaj te caktuar me vendimin Nr. 729 Regj. Themeltar date 17.08.2021 te Gjykates se Apelit Tirane.
- Shpenzimet procedurale i ngarkohen te pandehurit.
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditesh duke filluar nga e nesermja e njoftimit te ketij vendimi.

U shpall sot ne daten 28.02.2022.

Sekretare
Besarda Allaraj

Gjyqtar
Altin Abdiu

Shpenzime gjyqësore
Fletethirrje 3x150 leke
Hetimet paraprake 5000 lekë